



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1514/24 Datë: 05.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 3/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të në mbledhjen e 126 të mbajtur më datë 22.07.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - o Programim BA Profesional 180 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;
- II. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - o Programim dhe Multimedia BA Profesional 180 A, me kuotën maksimumi 65 studentë për vit akademik;
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji AAB kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Programim BA Profesional 180 ECTS R	Shkelqim Miftari Edlira Qefalija Florijeta Hulaj
2.	Programim dhe Multimedia BA Profesional 180 A	Taulant Zeka Ramiz Hoxha Malësore Gashi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Kolegjin AAB kampusi kryesor, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Maurizio Ferrari Dacrema, Seifedine Kadry dhe Lali Giorgidze.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Programim BA Profesional 180 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 21.05.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2), Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; Programim dhe Multimedia BA Profesional 180**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 21.05.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2), Substancialisht katër (4) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 126 të mbajtur me datë 03.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Kolegjit AAB kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër si dhe dispozitave ligjore në fuqi, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë